

SHQIPËRIA NË DOKUMENTET AUSTRO-HUNGAREZE

VITI 1912

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I HISTORISË – TIRANË

**SHQIPËRIA NË DOKUMENTET
AUSTRO-HUNGAREZE**

(1912)

VËLLIMI IV

(11 korrik - 24 gusht)

Përgatitja dhe redaktimi

**Prof. dr. ANA LALAJ
Prof. dr. ERIKETA KAMBO
Dr. SONILA BOÇI**

Tiranë, 2012

Drejtues i Projektit
Akad. Assoc. Marenglen VERLI

Redaktor përgjegjës i vëllimit:
Prof. dr. Ana LALAJ

Korrektimi i përkthimeve:
Dr. Edmond MALAJ

Korrektimi letrar:
Meliha BALLA

Përkujdesja grafike:
Mirela MIHALI & Dorina MUKA

Kopertina:
Dorina MUKA

MIRATUAR NË GRUPIN E PROJEKTTIT

© Copyright: QSA, Instituti i Historisë – Tiranë dhe përgatitësit

ISBN

Botimet Albanologjike

KY KORPUS DOKUMENTESH BOTOHET
ME RASTIN E 100-VJETORIT
TË SHPALLJES SË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

1912 - 2012

PARATHËNIE

Publikimi i dokumenteve historike për të kaluarën e shqiptarëve ka qenë dhe mbetet një detyrë e rëndësishme për historianët. Një gjë e tillë paraqitet veçanërisht e domosdoshme kur është fjala për ngjarje dhe dukuri me domethënie të jashtëzakonshme në historinë e shqiptarëve siç janë Kryengritja e Përgjithshme Antiosmane e vitit 1912 dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të po atij viti.

Viti 1912 është nga më të rëndësishmit në historinë moderne të kombit shqiptar. Ai nisi vrullshëm me mbledhjen në lagjen Taksim të Stambollit, në janar, ku u ngjiz ideja e Kryengritjes së Përgjithshme, për të përfunduar me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, në Vlorë, më 28 nëntor, një akt që i çeli rrugë ndërtimit të shtetit të pavarur shqiptar. Shpallja e shtetit të pavarur shqiptar dhe njohja e tij ndërkombëtare sanksionuan një të drejtë legjitime të kombit shqiptar për të cilën u luftua në shekuj, në rrugë e dinamika të ndryshme.

Për vetë peshën që ngjarjet e këtij viti mbartin, ato kanë qenë dhe janë objekt i një vëmendjeje të veçantë në letërsinë historike shqiptare dhe të huaj. Burimet dokumentare vendase apo të huaja përbëjnë lëndën e një varg studimeve të mirëfillta, që kanë arritur të përpilojnë me sukses sfondin historik të shqiptarëve, trevave dhe shtetit të tyre në atë vit të mbarë, 1912. Megjithatë ka ende shumë dokumente të shfrytëzuara pjesërisht apo që flenë nëpër arkiva, njohja dhe publikimi i të cilave krijon mundësi për studime më të thelluara të çështjes shqiptare. Pikërisht ky është motivi që nxiti studiuesit e Institutit të Historisë t'i hyjnë punës për përgatitjen e një varg botimesh dokumentare në këtë përvojë të njëqindtë të shtetit shqiptar të pavarur.

Në Arkivin e Institutit të Historisë pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, ruhet një fond i rëndësishëm i dokumenteve të Ministrisë së

Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien).

Zgjedhja për botim e këtij fondi, në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, nuk ka qenë e rastit.

Së pari, ky fond përbën një nga seksionet më të kompletuara të Arkivit të Institutit të Historisë. Ai ka filluar të formohet që në vitet '30 me prurjet që synonin t'i shërbenin organizimit të festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe u pasurua në përmasat që zotërojmë sot në vitet '50-'70, nën kujdesin e posaçëm të prof. Aleks Budës. Dokumentet e këtij fondi i kemi në shqip në saje të punës tejet të përkushtuar të një grupi përkthyesish: Veniamin Dashi, Henrik Lacaj, Maksut Shehu, Aleksandër Hivziu, Shefqet Hoti, Bexhet Shehu, Pjetër Rodiqi, Tomor Dani, Shuk Koka, Jaho Nuraj etj.

Së dyti, diplomacia austro-hungareze e fillimshekullit të XX ishte nga më aktivet në rajon. Madje për shqiptarët ndikimi i saj është i ndjeshëm në një hark kohor edhe më të gjerë, që përfshin periudhën e Rilindjes Kombëtare deri në vitin 1918 pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. E interesuar posaçërisht për Ballkanin, Perandoria Habsburgase ka ndjekur me vëmendje të veçantë proceset kulturore, politike, ekonomike në trevat shqiptare ende nën sundimin osman, si dhe raportet e tyre me shtetet ballkanike përreth. Perandoria ishte e pranishme në këto treva me përfaqësi të shumta diplomatike; ajo kishte kryekonsullata në qendrat e katër vilajeteve shqiptare, përkatësisht në Shkodër, në Manastir, në Janinë e në Shkup, si dhe konsullata në shumë qytete të tjerë.

Së treti, raportet konsullore austro-hungareze dallohen nga thellësia dhe gjerësia e informacionit historik. Natyrisht, dokumentet kanë dhe nota subjektivizmi por përsëri informacioni që na përcjellin është i vyer, pasi diplomatët e Vjenës ishin njerëz të mirëarsimuar e diplomatë karriere me përvojë. Njëherësh ata kishin në dispozicion burime të shumta financiare, që u mundësonin njohje të gjera në terren dhe informacione të shumta e të rëndësishme.

Së katërti, dokumentacioni austro-hungarez përveç hapësirës shqiptare, mbulon edhe vendet fqinje. Letërkëmbimi i shkëmbyer midis s dhe diplomatëve austro-hungarezë ndërmjet tyre dhe me Vjenën, bën të qartë se një varg ngjarjesh në vilajetet shqiptare lidhen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi me shtetet ballkanike dhe me Fuqitë e Mëdha. Një gjë e tillë ndihmon

lexuesit të vlerësojnë drejt proceset dhe figurat që spikasin në këtë moment historik për kombin shqiptar.

Në dokumentet në fjalë gjenden të dhëna për numrin e shqiptarëve, për shtrirjen e tyre, për veçoritë etnike, për virtytet e veset në krahina të ndryshme, mandej për nivelet e zhvillimit ekonomik, social, arsimor, kulturor, e mbi gjithçka për aspiratat e veprimtaritë e tyre politike-ushtarake. Vilajetet shqiptare, që shpesh në dokumentet diplomatike të kohës quheshin "Shqipëri", zinin një vend me rëndësi në strategjinë e Perandorisë Dualiste, atëkohë, një nga fuqitë kryesore të Koncertit Evropian. Dokumentet austro-hungareze të botuara e shpalosin qartë këtë strategji, në kontekst të marrëdhënieve me Perandorinë Osmane, me Fuqitë e Mëdha evropiane dhe me vendet e tjera të Ballkanit.

Sa i përket vitit 1912, ky fond ka të dhëna me interes për ngjarje, që lidhen me Kryengritjen e Përgjithshme të atij viti, me Luftën Ballkanike dhe me momentin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në këtë kuadër jepen informacione interesante për lëvizjet politike të shqiptarëve, veprimet kryengritëse në të gjitha trevat shqiptare, shqetësimin e ankthin e elitës politike shqiptare për të ardhmen e vendit, përpjekjet e personaliteteve politikë shqiptarë për të siguruar mbështetje në radhët e faktorit ndërkombëtar, veçanërisht të atyre Fuqive të Mëdha që për momentin ishin të prirura pozitivisht ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare etj. Njëkohësisht bëhen të njohura dhe angazhimet e refleksionet e fqinjëve dhe shteteve evropiane për atë çka po ndodhte në Shqipëri.

*Dokumentet e këtij vëllimi (IV), gjithsej 217, përfshijnë periudhën kohore 11 korrik - fund i gushtit të vitit 1912. Megjithëse një hark kohor relativisht i shkurtër, ai është i mbushur me ngjarje të shumta e të rëndësishme që kulmojnë me kuvendin e Sinjës pranë Beratit; me kuvendin e Vlorës (në fillim të gushtit); me mbledhjen e Filatit, me memorandumin e mirditasve dhe me kryengritjen e përgjithshme shqiptare, që i dorëzoi memorandumin prej 12 pikësh Ibrahim Pashës, kryetarit të Komisionit të Jashtëzakonshëm për Shqipërinë, i dërguar nga Sulltani për të njohur e studiuar ankesat shqiptarëve. Këto veprimtari kanë në themel të tyre **kërkesën për autonomi të Shqipërisë**. Raportet austro-hungarezë flasin për një bashkëpunim intensiv të personaliteteve kryesorë shqiptarë në të gjithë viset shqiptare: në Kosovë, në Shkodër, në Manastir, në Elbasan, në Vlorë, e deri në Prevezë e Filat. Përmenden emrat e Ismail Qemalit, Isa Boletinit, Dervish Himës, Hasan Prishtinës, Pandeli Cales, Ahmet efendi*

Daklit, Lef Nosit, Luigj Gurakuqit, Qamil Panaritit, Haxhi Fuatit, Ali Çaushtit, e shumë e shumë të tjerëve, që përpiqen të gjallërojnë lëvizjen kombëtare duke i kërkuar Stambollit në rrugë diplomatike dhe me forcën e armëve respektimin e të drejtave kushtetuese, vetëqeverisëse, kulturore, fetare, arsimore të shqiptarëve. Në muajt që përfshihen në këtë përmbledhje dokumentesh, edhe Monarkia austro-hungareze duke rekomanduar dhe mbështetur reformat decentralizuese administrative të brendshme në zotërimet evropiane të Perandorisë Osmane, në mënyrë të tërthortë çonte ujë në kërkesat e shqiptarëve për autonomi. Por Porta e Lartë nuk u dha shqiptarëve atë çka kërkonin. Ky qëndrim ndikoi në radikalizmin e veprimtarisë së tyre politike. Pikërisht në këtë moment historik, është meritë e personaliteteve politikë shqiptarë, që arritën të dalin përtej “mureve” të Perandorisë dhe të kërkojnë bashkërendim të veprimeve të tyre me ata shtete, me të cilët u përkonin më shumë interesat.

Përgatitësit për botim kanë treguar një kujdes të veçantë që përmbajtja e dokumenteve të jepet e saktë, e qartë, duke e afruar gjuhën e përkthimit me atë letrare dhe duke ruajtur sa të ishte e mundur stilin e përkthyesit. Heraherës është ndërhyrë me shënime e sqarime plotësuese brenda në tekst ose në fund të tij. Dokumentet botohen të plota me përjashtim të rasteve kur teksti në origjinal ka qenë i palexueshëm ose i fshirë, si edhe në ndonjë rast kur është vlerësuar se informacioni nuk ka lidhje me botën shqiptare.

Së fundmi, është kënaqësi t’u shprehët falënderim e mirënjohje studiuesve të atyre gjeneratave të Institutit të Historisë, të cilët u angazhuan për pasurimin e fondeve të Arkivit të këtij Instituti me dokumentet diplomatike të Arkivit të Vjenës, gjë që bëri të mundshëm edhe publikimin e tyre sot sipas kriterëve shkencorë bashkëkohorë. Një falënderim e nderim i veçantë u shkon gjithashtu përkthyesve, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar për sjelljen në shqip të regjistrimeve arkivore austro-hungareze aq me vlerë për historinë tonë kombëtare.

GRUPI I PROJEKTIT

PËRMBAJTJA E DOKUMENTEVE

-1-

Informacion i atasheut ushtarak, Pomiankowski, për eprorët e tij në Vjenë, lidhur me situatën e krijuar për shkak të dezertimeve të oficerëve dhe ushtarëve në Manastir e bashkimin e tyre me forcat kryengritëse shqiptare

Konstandinopojë, më 11 korrik 1912

- 2-

Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, drejtuar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, lidhur me shthurjen në radhët e ushtarakëve osmanë dhe rritjen e rezistencës së shqiptarëve nën drejtimin e Idriz Seferit

Shkup, më 12 korrik 1912

-3-

Raport i konsullit austro-hungarez në Smirna, dërguar ministrit të Jashtëm, Berchtold, për disa kërcënime që oficerët i kanë bërë ministrit të Luftës të qeverisë osmane, Mahmud Shevket pashës

Smirnë, më 14 korrik 1912

- 4-

Konsulli austro-hungarez në Janinë, Bilinski, njofton Ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, mbi rritjen e pasigurisë në Filat (Çamëri), si rezultat i gjallërimit të veprimtarisë së bandave keqbërëse në këtë zonë

Janinë, 18 korrik 1912

- 5-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, drejtuar eprorëve të tij në Vjenë, lidhur me lëvizjet e trupave ushtarake drejt Ferizajt

Shkup, më 18 korrik 1912

- 6-

Informacion i konsullatës austro-hungareze në Beograd, për Ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me shqetësimin e Serbisë për revoltën në Manastir

Beograd, më 18 korrik 1912

-7-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Prizren, Prochaska, lidhur me situatën e tensionuar, të krijuar si rezultat i humbjes së trupave osmane të garnizonit të Gjakovës

Prizren, më 18 korrik 1912

- 8-

Raporti i nënkonsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, drejtuar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, lidhur me humbjet e forcave osmane në Barilevë e Podujevë, si dhe përpjekjet e Portës për të shtypur rezistencën e popullsisë shqiptare në qytetin e Prishtinës e rrethinat e saj

Mitrovicë, më 18 korrik 1912

- 9-

Konsulli austro-hungarez në Selanik, Kral, informon ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, për organizimin e mundshëm të një mbledhjeje në Nicë me përfaqësues nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare, me synim njohjen nga Evropa të të drejtave të kombit shqiptar dhe ku do të jenë pjesëmarrës Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina

Selanik, më 18 korrik 1912

-10-

Informacion i kryekonsullit austro-hungarez të Janinës, Bilinski, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, lidhur me masat e ashpra të autoriteteve lokale dhe komandës ushtarake osmane ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Jug, për kufizimin e përhapjes së saj

Janinë, më 18 korrik 1912

- 11-

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, dërguar eprorëve në Vjenë, për situatën e krijuar pas rënies së kabinetit qeveritar të Seid Pashës

Stamboll, më 18 korrik 1912

-12-

Informacion nga ambasada austro-hungareze në Stamboll, dërguar eprorëve në Vjenë, lidhur mbi marrëdhëniet e Perandorisë Osmane me Rumaninë dhe për perspektivën e një aleance të mundshme ushtarake midis tyre

Stamboll, më 19 korrik 1912

-13-

Konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, u përcjell eprorëve të tij në Vjenë një thirrje drejtuar korpusit të oficerëve osmanë, për të dhënë kontributin e tyre në rrëzimin e kabinetit qeveritar.

Shkup, më 19 korrik 1912

-14-

Telegrami i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për eprorët në Vjenë, lidhur me lëvizjet e trupave osmane në vilajet

Shkup, më 19 korrik 1912

-15-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Selanik, Kral, dërguar eprorëve në Vjenë, lidhur me një ftesë të oficerëve të divizionit të Gjakovës drejtuar oficerëve të Shtabit të Përgjithshëm për të ndërmarrë veprime të përbashkëta

Selanik, më 19 korrik 1912

-16-

Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, dërguar ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, lidhur me gjendjen në korpusin e oficerëve në Vilajetin e Kosovës

Shkup, më 19 korrik 1912

-17-

Raport i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini në lidhje me gjendjen politike në Vilajetin e Kosovës

Shkup, më 19 korrik 1912

-18-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për eprorët e tij në Vjenë, lidhur me lëvizjen e trupave ushtarake në vilajetin e Kosovës

Shkup, më 20 korrik 1912

-19-

Informacion i konsullatës austro-hungareze në Korfuz, Alber, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me dëbimin e Dervish Himës dhe kalimin e tij në Shqipërinë e Jugut, si dhe për ardhjen aty të Ismail Qemalit dhe kontaktet e tij me autoritetet

Korfuz, më 20 korrik 1912

-20-

Ambasadori austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, njofton eprorët e tij në Vjenë, lidhur me kërkesën për një kabinet të Qamil Pashës pa Turqit e Rinj, që Lidhja e Fshehtë e Oficerëve ia ka drejtuar Këshillit të Lartë të Luftës

Stamboll, më 20 korrik 1912

-21-

Ambasadori austro-hungarez në Selanik, Kral, i raporton ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, për qëndrimin e kabinetit xhonturk ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për përfaqësuesit politikë të autoriteteve lokale ndaj kësaj lëvizjeje në rritje, si dhe për oficerët osmanë të korparmatës së Selanikut

Selanik, më 20 korrik 1912

-22-

Telegram i atasheut ushtarak austro-hungarez në Stamboll, kolonel Pomiankowski, paraqitur eprorëve në Vjenë, për refuzimin e trupave të dezertuar nga Manastiri që të dorëzohen vullnetarisht, si dhe për veprimet luftarake të kryengritësve shqiptarë

Stamboll, më 20 korrik 1912

-23-

Telegram i atasheut ushtarak austro-hungarez në Stamboll, Pomiankowski, për eprorët në Vjenë, lidhur me programin e Lidhjes së Fshehtë të Oficerëve "Grupi i Oficerëve Shpëtimtarë"

Stamboll, më 20 korrik 1912

-24-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, dërguar Ministrisë së Luftës në Vjenë, për veprimet e kryengritësve shqiptarë në zonën Shkodër-Lezhë

Shkodër, më 21 korrik 1912

-25-

Telegrami i konsullit të Prizrenit, Prochaska, drejtuar eprorëve në Vjenë, mbi vendosjen e lidhjes telegrafike në këtë rajon

Prizren, më 21 korrik 1912

-26-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, për eprorët e tij në Vjenë, lidhur me pranimin e dorëheqjes së qeverisë nga Sulltani dhe dërgimin prej tij të një komisioni në Shqipëri për të dëgjuar kërkesat shqiptare

Mitrovicë, më 21 korrik 1912

-27-

Telegrami i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, dërguar eprorëve në Vjenë, për futjen e kryengritësve shqiptarë në Prishtinë dhe rrethinat e saj

Mitrovicë, më 21 korrik 1912

-28-

Konsullata e Prizrenit, informon Vjenën për mosdërgimin e postës për shkak të mbylljes së rrugëve nga kryengritësit, si dhe vendosjen e kontakteve pas rregullimit të lidhjes telegrafike

Prizren, më 21 korrik 1912

-29-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, dërguar eprorëve në Vjenë, për vendosjen e një bombe në trenin e udhëtarëve

Shkup, më 21 korrik 1912

-30-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, dërguar eprorëve në Vjenë, lidhur me udhëtimin e etnologes britanike, Edith Durham, nga Shkodra në Podgoricë

Shkodër, më 21 korrik 1912

-31-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, ku njofton qendrën në Vjenë, mbi vendosjen e lidhjeve telegrafike me Prizrenin

Shkup, më 21 korrik 1912

32-

Kryekonsulli austro-hungarez në Janinë, Bilinski, njofton ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, mbi zgjerimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Shqipërinë e Jugut dhe përpjekjet e Dervish Himës e atdhetarëve të tjerë për organizimin e një kryengritje të përgjithshme

Janinë, më 21 korrik 1912

-33-

Konsulli austro-hungarez në Berat, Leyhanec, i raporton ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, për situatën e vështirë politike të krijuar në sanxhakun e Beratit si rezultat i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si dhe për panikun e zgjerimit në radhët e formacioneve ushtarake osmane

Berat, më 22 korrik 1912

-34-

Kryekonsulli i Austro-Hungarisë në Janinë, Bilinski, njofton ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, lidhur me gjallërimin e propagandës për çështjen kombëtare në popullsinë e krishterë të Shqipërisë së Jugut

Janinë, 22 korrik 1912

-35-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, drejtuar Ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, për situatën politike të krijuar si rezultat i dezertimeve dhe shturjeve në formacionet osmane, gjallërimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në zonat juglindore të vendit, si dhe thellimin e përpjekjeve për të kaluar drejt një kryengritje të përgjithshme.

Manastir, më 22 korrik 1912

-36-

Njoftim i Ministrisë së Jashtme në Vjenë dërguar konsullatës austro-hungareze në Durrës, për një ndërhyrje që duhet të bëjë ajo pranë autoriteteve osmane, që kanë ngritur padi për një pasuri të kishës katolike greke në Elbasan, si dhe mbulimin e shpenzimeve për këtë qëllim

Vjenë, më 22 korrik 1912

-37-

Telegrami i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, dërguar eprorëve në Vjenë, të cilët i informon për lëvizjen e trupave osmane në këtë rajon

Shkup, më 22 korrik 1912

-38-

Konsulli austro-hungarez në Vlorë, Leyhanec, njofton eprorët në Vjenë, për ardhjen e forcave osmane dhe rritjen e lëvizjes kryengritëse në Berat

Vlorë, më 23 korrik 1912

-39-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, për eprorët e tij në Vjenë, lidhur me tërheqjen e trupave osmane nga Boletini dhe zgjerimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në Kosovë

Mitrovicë, më 23 korrik 1912

-40-

Konsulli austro-hungarez në Shkup, Heimroth, informon eprorët në Vjenë, për lëvizjet e forcave osmane drejt Ferizajt

Shkup, më 23 korrik 1912

-41-

Konsulli austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, informon Golluhowskin, funksionar i lartë në Vjenë, për situatën politike të krijuar në Novi Pazar e në Mitrovicë si rezultat i hyrjes së forcave kryengritëse nën drejtimin e Isa Boletinit

Mitrovicë, më 23 korrik 1912

-42-

Raport i konsullit austro-hungarez në Prizren, Prochaska, dërguar ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me një tentativë arratisje të të burgosurve në Prizren dhe qëndrimin e ashpër të autoriteteve osmane

Prizren, më 23 korrik 1912

-43-

Konsulli austro-hungarez në Prizren, Prochaska, i dërgon informacion ministrit të jashtëm në Vjenë, Berchtold, për lëvizjet e fundit të garnizonit osman në rajonin e Prizrenit

Prizren, më 23 korrik 1912

-44-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për eprorët në Vjenë, lidhur me efektin qetësues që ka pasur formimi i kabinetit qeveritar

Manastir, më 23 korrik 1912

-45-

Konsulli austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, informon ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, për përhapjen e kryengritjes në Kosovë, reagimin e popullsisë dhe tërheqjen në panik të garnizoneve ushtarake osmane

Mitrovicë, më 24 korrik 1912

-46-

Konsulli austro-hungarez në Manastir, Halla, i dërgon ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, përmbledhjen e një thirrjeje ku bëhet përgjegjëse qeveria osmane për reprezaljet ndaj shqiptarëve, si dhe kërkesat e tyre për mbrojtjen e interesave kombëtare

Manastir, më 24 korrik 1912

-47-

Raport i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me situatën e përgjithshme politike, si dhe jehonën që patën te shqiptarët e Vilajetit të Manastirit ndryshimet e lajmëruara në përbërjen e qeverisë osmane

Manastir, më 24 korrik 1912

-48-

Raport i konsullatës austro-hungareze në Durrës, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, lidhur me reagimin e shqiptarëve ndaj ndryshimeve në qeverinë osmane

Durrës – Tiranë, më 24 korrik 1912

-49-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Janinë, Bilinski, për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, lidhur me gjendjen politike në Vilajetin e Janinës

Janinë, më 24 korrik 1912

-50-

Letër e Dervish Himës për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, ku flitet për veprimtarinë e tij në sanxhakun e Gjirokastrës; për mitingun e shqiptarëve në viset e Jugut dhe kërkesat e tyre; për solidarizimin me kërkesat e shqiptarëve në Veri etj.

Gjirokastrë, më 24 korrik 1912

-51-

Raport i atasheut ushtarak të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pomiankowski, për shefin të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë austro-hungareze, për fillimet e kryengritjes së përgjithshme në Shqipëri dhe zhvillimet kryesore të saj

Konstandinopojë, më 25 korrik 1912

-52-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, mbi veprimtarinë e pretendentit për fronin shqiptar, Aladro Kastrioti

Shkup, më 25 korrik 1912

-53-

Telegram i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi takimin e tij me kryeministrin, si dhe me ministrin e Jashtëm të Perandorisë Osmane, ku është diskutuar mbi situatën në Shqipëri

Konstandinopojë, më 25 korrik 1912

-54-

Raport dite mbi një vizitë të ambasadorit francez, z. Dumaine, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Austro-Hungareze, ku është biseduar në lidhje me qëndrimin e mbretit Nikola të Malit të Zi ndaj turbullirave në Shqipëri; si dhe rreth zhvillimeve në frontin e luftës italo-osmane dhe fatin e provincave libaneze

Vjenë, më 25 korrik 1912

-55-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, lidhur me subvencionet që ka marrë Mustafa Hilmiu për botimin e gazetës "Drita"

Manastir, më 25 korrik 1912

-56-

Raport i konsullatës austro-hungareze në Mitrovicë, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, mbi zbatimin e vendimit të Portës së Lartë për të kremtuar përvjetorin e Betejës së Fushë-Kosovës dhe qëndrimi i shqiptarëve ndaj këtij kremtimi

Mitrovicë, më 25 korrik 1912

-57-

Relacioni i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, për ministrin e Jashtëm, Berchtold, mbi situatën politike në Perandorinë Osmane dhe ndikimin që ka pasur lufta italo-osmane në të

Jenikoj, më 25 korrik 1912

-58-

Njoftim i ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për veprimtarinë e Dervish Himës dhe subvencionet që i janë akorduar atij

Konstandinopojë, 25 korrik 1912

-59-

Informacion i ambasadorit të Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, për Ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, mbi kërkesat që "Lidhja Ushtarake" i ka paraqitur qeverisë osmane

Jenikoj, më 25 korrik 1912

-60-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për Ministrinë e Punëve të Jashtme, mbi lëvizjet e trupave ushtarake osmane

Shkup, më 25 korrik 1912

-61-

Raport i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, për çështjen e pronësisë së një trualli të kishës greke në Elbasan

Jenikoj, më 25 korrik 1912

-62-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, mbi zhvillimet e kryengritjes shqiptare në zonën e Mirditës, Pukës dhe Lezhës

Shkodër, më 25 korrik 1912

-63-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Janinë, Bilinski për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, për disa ndryshime në protokollin e festave në Vilajetin e Janinës

Janinë, më 26 korrik 1912

-64-

Informacion i përfaqësuesit austro-hungarez në Vlorë-Berat, Bostil, për ministrin Punëve të Jashtme, Berchtold mbi një mesazh që Ismail Qemali i ka drejtuar kryengritësve në Shqipërinë e Jugut dhe mbi situatën politike në këtë rajon

Vlorë-Berat, më 26 korrik 1912

-65-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Selanik, Kral, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, në lidhje me disa telegrame urimi të krerëve të Kosovës për Vezirin e Madh, ministrave kryesorë të qeverisë osmane, si dhe një telegram të përbashkët të tyre drejtuar Sulltanit

Selanik, më 26 korrik 1912

-66-

Konsulli austro-hungarez në Prizren, Prochaska, i raporton ministrit të Jashtëm në Vjenë, Berchtold, për situatën politike në vilajetin e Kosovës

Prizren, më 27 korrik 1912

-67-

Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë për konsullatat e saj në Shkodër, në Vlorë, në Shkup, në Mitrovicë, në Durrës, në Janinë, në Prizren, në Manastir mbi qëllimet e komisionit të dërguar në Shqipëri dhe qëndrimin e Portës së Lartë ndaj kërkesave të shqiptarëve

Vjenë, më 27 korrik 1912

-68-

Ministri i Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, i kërkon ambasadës së Austro-Hungarisë në Stamboll, të ndërmjetësojë për zgjidhjen e një incidenti të ndodhur me një kishë katolike

Vjenë, më 27 korrik 1912

-69-

Relacion i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, lidhur me veprimtarinë e bandave në Vilajetin e Manastirit

Manastir, më 27 korrik 1912

-70-

Telegram i konsullit austro-hungarez në Vlorë, Leyhanec, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, i cili njofton mbi lëvizjen e trupave ushtarake osmane

Vlorë, më 27 korrik 1912

-71-

Njoftim i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë austro-hungareze mbi një telegram që i është dërguar atij nga atasheu ushtarak i Austro-Hungarisë në Stamboll, lidhur me situatën në territoret shqiptare

Vjenë, më 28 korrik 1912

-72-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, lidhur me dislokimin e trupave ushtarake osmane në Vilajetin e Manastirit

Manastir, më 28 korrik 1912

-73-

Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me reagimin që ka shkaktuar në Vilajetin e Shkodrës shpallja e qeverisë së re osmane

Shkodër, më 28 korrik 1912

-74-

Telegram i konsullatës austro-hungarez në Shkup për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, ku njoftohet rreth luftimeve të një bande bullgare kundër forcave të xhandarmërisë osmane

Shkup, më 28 korrik 1912

-75-

Relacion i konsullit austro-hungarez në Shkup, Heimroth, për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, rreth lëvizjeve të bandave bullgare në Vilajetin e Kosovës

Shkup, më 28 korrik 1912

-76-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Selanik, Kral, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me kërkesat e shqiptarëve kryengritës ndaj qeverisë osmane

Selanik, më 29 korrik 1912

-77-

Njoftim i përfaqësuesit austro-hungarez në Ferizaj për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, në lidhje me qëndrimin e shqiptarëve lidhur me çështjen e pasardhësit të fronit perandorak osman

Ferizaj, më 29 korrik 1912

-78-

Relacion i përfaqësuesit austro-hungarez në Durrës, Pollanz, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, mbi një bisedë që ai ka zhvilluar me Murat Toptanin për situatën në Shqipëri

Durrës-Tiranë, më 29 korrik 1912

79-

Relacion i referentit të Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë për eprorët e tij, lidhur me një bisedë që ai ka zhvilluar me Fazil pashë Toptanin

Vjenë, më 29 korrik 1912

-80-

Kërkesë e konsullit austro-hungarez në Prizren, Prochaska, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, lidhur me sigurimin e disa mjeteve shkollore për shkollën e vajzave në Prizren

Prizren, më 30 korrik 1912

-81-

Kërkesë e konsullit austro-hungarez në Prizren, Prochaska, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold, mbi dërgimin e teksteve shkollore për shkollat katolike

Prizren, më 30 korrik 1912

-82-

Raport i konsullit austro-hungarez në Selanik, Kral, për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, lidhur me takimin e zhvilluar nga kryengritësit shqiptar në Sinjë

Selanik, më 30 korrik 1912

-83-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Manastir, Halla, për ministrin e Jashtëm në Vjenë, Berchtold lidhur me zhvillimet e kryengritjes shqiptare në Vilajetin e Manastirit

Manastir, më 30 korrik 1912

-84-

Telegram i konsullatës austro-hungareze në Mitrovicë, për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, ku njofton mbi mosmarrëveshjet midis shqiptarëve kryengritës dhe anëtarëve të komisionit qeveritar osman

Mitrovicë, më 30 korrik 1912

-85-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, dërguar ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, mbi hyrjen e Isa Boletinit në Novi Pazar dhe Mitrovicë, si dhe qëndrimin e popullsisë së këtyre krahinave

Mitrovicë, më 30 korrik 1912

-86-

SHTOJCË e raportit Nr. 36/*rez* të konsullit austro-hungarez në Mitrovicë

-87-

Njoftim i përfaqësuesit austro-hungarez në Berlin, Szögyény në lidhje me një intervistë të kancelarit gjerman, Bethmam Hollweg, dhënë për gazetën

“Politika Ndërkombëtare”, ku paraqitet politika gjermane ndaj çështjes shqiptare

Berlin, më 30 korrik 1912

-88-

Raport i konsullit austro-hungarez në Janinë, Bilinski, për ambasadorin e Austro-Hungarisë në Stamboll, Pallavicini, në lidhje me kërkesat arsimore dhe kulturore të shqiptarëve në Shqipërinë e Jugut

Janinë, më 31 korrik 1912

-89-

Raport i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, mbi qëndrimin e bejlerëve të Pejës ndaj kryengritjes shqiptare të Veriut

Mitrovicë, më 31 korrik 1912

-90-

SHTOJÇË e raportit Nr. 43 të konsullit austro-hungarez në Mitrovicë

31 korrik 1912

-91-

Informacion i konsullit austro-hungarez në Mitrovicë, Tahy, për kontin fon Golluhowski në Vjenë, në lidhje me zhvillimet në kryengritjen e shqiptarëve në Kosovë

Korrik 1912

-92-

Njoftim i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, në lidhje me informacionin që ai kishte rreth një mbledhjeje të krerëve kryengritës shqiptarë në Orosh

Shkodër, më 1 gusht 1912

-93-

Raport i konsullit austro-hungarez në Cetinë, Weincettl, për ministrin e Punëve të Jashtme, Berchtold, në lidhje me qëndrimin e shqiptarëve të Malit të Zi ndaj kryengritjes, si dhe për marrëdhëniet e tyre me Malin e Zi dhe Portën e Lartë

Cetinë, më 1 gusht 1912

-94-

Informacion i drejtorit të Bankës së Vjenës, Popper, për të dërguarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Pogatscher, mbi transaksionet bankare të bëra për llogari të Dervish Himës nga një person i quajtur Arthur Rabler

Vjenë, më 1 gusht 1912

-95-

Telegram i ambasadorit austro-hungarez në Stamboll, Pallavicini, për eprorët e tij në Vjenë, ku informon për një deklaratë të bërë nga Veziri i Madh, Ahmet Muhtar pasha, për politikën e jashtme të Perandorisë Osmane

Konstandinopojë, më 1 gusht 1912

-96-

